

MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 60, dt. 02.04.2015

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 02.04.2015, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Rikualifikimi urban i parkut “Aqif Pasha” dhe “Bazilikës”, Elbasan me këto vërejtje:
Të hiqet rrethimi i Muzeut Etnografik. Të eliminohet rrugica e propozuar në projekt. Rrapi të mos hiqet pasi është monument natyror. Pedana e propozuar dhe muri mbajtës të shqyrtohen në KKA dhe të zbatohet vendimmarrja e saj.
2. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI